



Forumi ekonomik Poloni-Shqipëri, nënshkruhen dy marrëveshje bashkëpunimi



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në bashkëpunim me Ambasadën e Polake, organizuan në Tiranë Forumin ekonomik Shqipëri-Poloni. Ky forum u mbajt në kuadër të vizitës në Tiranë të Kryeministres së Polonisë Beata Szydlo, e cila shoqërohej në këtë vizitë nga një grup përfaqësuesish të biznesit e sipërmarrjes polake. Në fokus të këtij forumi ishin investimet polake në Shqipëri si dhe bashkëpunimi mes bizneseve të dy vendeve. Forumi u përshëndet nga Kryeministri Edi Rama dhe Kryeministrja Beata Szydlo. “Shqipëria ka qenë një destinacion tërheqës turistik, por vit pas viti, ajo po zbulohet si e tillë dhe vit pas viti, shifrat po flasin për një atraksion real të ri, në Mesdhe. Nuk është një destinacion i eksploruar gjerësisht më parë dhe kjo e bën edhe më tërheqës, por sigurisht, ne kemi nevojë që të investojmë në mënyrë cilësore, për të krijuar kushte optimale që ky destinacion t’i shërbejë sa më shumë turistëve”,- tha zoti Rama gjatë fjalës së tij, duke shtuar se turizmi nuk është e vetmja fushë ku bizneset polake mund të investojnë. Ai foli për potencialet hidroenergjitike, burimet naftëmbajtëse, potencialet në bujqësi, manifakturë, duke ftuar bizneset polake t’i shfrytëzojnë këto mundësi. Ndërsa Kryeministrja Polake nga ana e saj duke nënvizuar bashkëpunimin e shkëlqyer politik mes dy vendeve theksoi se e rëndësishme është që dhe lidhjet ekonomike të jenë tepër të forta. Ajo theksoi se Polonia në këtë forum pati mundësinë për të prezantuar ofertën e vet të eksportit në fushën e energjisë, prodhimit të makinerive, pajisjeve bujqësore, si dhe të fruta-perimeve e produkteve ushqimore të përpunuara, duke shpresuar që kjo ofertë të konsiderohet interesante nga pala shqiptare. Gjatë punimeve të Forumit u nënshkruan edhe dy marrëveshje në fushën e ekonomisë; Marrëveshja mes Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, AIDA dhe Agjencisë Polake të Investimeve, dhe Marrëveshja mes Unionit të Dhomave të Tregtisë të dy vendeve. Këto memorandume mirëkuptimi do t’i hapin rrugë intensifikimit të marrëdhënieve mes dy vendeve si në drejtim të investimeve dhe të marrëveshjeve tregtare. Gjatë forumit u zhvilluan edhe takime B2B, mes bizneseve të dy vendeve, për të vendosur kontakte dhe për gjetur urat e bashkëpunimit. Kompani polake të disa fushave përfshi energjinë, transportin, distributorë të produkteve të mishit, etj u takuan me kompani shqiptare të interesuara për të parë mundësitë e bashkëpunimit dhe për të vendosur partneritete të ndryshme biznesi.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/zvillohet-ne-tirane-forumi-ekonomik-poloni-shqiperi>

Komiteti i Lehtësimit të Tregtisë, në ndihmë të bizneseve eksportuese



Në Ministrinë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë e Sipërmarrjes u zhvillua mbledhja e dytë e Komitetit të Lehtësimit të Tregtisë. Ky komitet drejtohet nga Ministria e Ekonomisë, znj Milva Ekonomi dhe në përbërje të tij janë përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Integritimit, përfaqësues të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë, përfaqësues të USAID. Qëllimi i krijimit të këtij Komiteti është të zgjidhë problematikat që bizneset hasin në çështjet e eksportit të produkteve të tyre jashtë Shqipërisë. Tematika e takimit të radhës ishte miratimi i rregullores së Komitetit të Lehtësimit të Tregtisë, dhe prezantimi i planit operacional. Gjithashtu, u diskutua për Sekretarinë Teknike tashmë të krijuar brenda MZHETTS, synimi i së cilës është të presë shqetësimet e biznesit për lehtësimin e tregtisë. Kjo strukturë do të shërbejë si hap i parë për krijimin e një “help desku” (me vlerë 6 mln lekë), tek i cili bizneset do të drejtohen dhe marrin informacione mbi procedurat dhe kërkesat teknike, që duhet të kenë produktet sipas tregjeve ku eksportohet. Për funksionimin e kësaj sekretarie, Ministria e Ekonomisë kërkoj që përfaqësuesit e institucioneve të pranishëm, të kontribuojnë me ekspertë dhe staf, në mënyrë që t’u jepet sa më shpejt e saktë përgjigje shqetësimeve të bizneseve që eksportojnë. Të pranishmit diskutuan në vijim mbi disa raste vështirësish tregtimi të hasura së fundi nga eksportuesit shqiptarë lidhur me nënproduktet e qumështit, eksportin e limonëve, domateve etj. Këto problematika vijnë edhe si rezultat i mungesës së dokumentacionit përkatës të eksportuesve shqiptarë, të cilët duhet të kenë certifikatën e analizave të produktit, një etiketim dhe ambalazhim më cilësor etj. Ministria shtoi se AIDA mund të përdoret nga bizneset prodhuese, për t’u rritur produkteve cilësinë e paketimit dhe etiketimit, ndërsa kërkoj nga Ministria e Bujqësisë dhe AKU që t’ua bëjnë të qartë fermerëve kushtet që duhet të plotësojë një produkt para se të eksportohet. Përfaqësuesi i USAID dhe Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë u angazhuan për të mbështetur menjëherë Sekretarinë Teknike, për lançimin sa më shpejt të ‘Help Desk’.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/komiteti-i-lehtesimit-te-tregtise-ne-ndihme-te-bizneseve-eksportuese>

Ministrja Ekonomi: Zonat e Mbrojtura të shihen të lidhura me zhvillimin ekonomik



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj Milva Ekonomi mori pjesë në Forumin Koordinues “Rrjeti i Zonave të Mbrojtura: Modeli i ardhshëm i zhvillimit të qëndrueshëm – hapat e mëtejshëm për një menaxhim më të mirë”, organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Të pranishëm ishin z. Lefter Koka, Ministri i Mjedisit, Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë, Znj. Eglantina Gjermeni, Ministër i Zhvillimit Urban, si dhe përfaqësuesit më të lartë të organizatave partnere e donatore UNDP, Delegacioni Evropian, GIZ etj. Në këtë takim u paraqitën arritjet e deritanishme në menaxhimin e zonave të mbrojtura. Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të dhënat e vitit që po mbyllet regjistrojnë trefishim të numrit të turistëve në Zonat e Mbrojtura, nga 400 mijë vizitorë në 2015, në mbi 1,56 milionë në 2016. Sipas Ministrisë së Mjedisit, gjatë vitit 2016 janë investuar rreth 6 milionë euro (nga qeveria dhe nga donator të huaj në vendin tonë) ndërsa vitin e ardhshëm do të vijojnë investime dhe deri më tani janë parashikuar rreth 3 milionë euro. Në fjalën e saj, Ministrja Ekonomi theksoi se zonat e mbrojtura nuk duhet të trajtohen thjesht si zona të rrethuara dhe të veçuara, por të shihen në këndvështrimin e zhvillimit ekonomik. Ajo vuri në dukje faktin se, numri i vizitorëve që vizituan parqet kombëtare të vendit tonë për këtë vit ishte 3.3 herë më shumë se sa në vitin e kaluar, dhe numri i vizitorëve vendas ishte më i madh se sa i vizitorëve të huaj. “Zona e mbrojtur nuk mund të jetë tabu, por ka nevojë që përdorimi i saj të lidhet dhe të shihet në këndvështrimin e zhvillimit ekonomik. Zonat e mbrojtura, kur bëhet fjalë për investimet strategjike, lidhen më shumë me ato investime që kanë në fokus turizmin dhe, sa herë që ka një iniciativë të këtij lloji, grupet ndër-ministeriale të punës operojnë me njëri-tjetrin”, tha Ministrja Ekonomi. Ministrja theksoi më tej se, iniciativat për zonat e mbrojtura janë iniciativa që i shërbejnë ardhmërisë së vendit dhe natyrisht i shërbejnë dhe ardhmërisë së përmirësimit të legjislacionit tonë, i cili duhet të shkojë në linjë me gjithë rekomandimet që japin direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-ekonomi-zonat-e-mbrojtura-te-shihen-te-lidhura-me-zhvillimin-ekonomik&page=1>

Ministrja Ekonomi merr pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të projektit “IDEA”



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes mbështet fuqimisht të gjitha iniciativat për nxitjen dhe promovimin e bizneseve start-up në Shqipëri. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj Milva Ekonomi ishte e pranishme në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të konkursit “Ide të reja biznesi”, i zhvilluar në kuadër të projektit IDEA, (Innovative Development for Entrepreneurs in Albania) mbështetur nga GIZ, në koordinim me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve-AIDA (institucion në varësi të MZHETTS). Në fjalën e mbajtur me këtë rast, znj. Ekonomi u shpreh entuziaste për rrugëtimin e projektit IDEA, i cili startoi në mes të korrikut me dilemat e gjetjes së trajnerëve dhe përfshirjes të sa më shumë bizneseve start-up në konkurrim, ndërsa sot ky projekt vjen me ide fituese. Ajo i ftoi këto biznese që të shfrytëzojnë dhe mundësitë që jep AIDA, e cila ka në dispozicion 6 lloj fondesh për zhvillimin e sipërmarrjes. Vetëm këtë vit, AIDA ka dhënë 128 mln lekë financime në mbështetje të sipërmarrjes, përfshi dhe ato start-up. Ndërkohë për start-up paketa e ndihmës për vitin 2016 ishte 10 mln lekë dhe kishte 32 kompani përfituese. Për dy vitet në vazhdim janë vënë në dispozicion 25 mln lekë dhe ky financim do të vazhdojë duke u rritur, shtoi ajo. Gjithashtu, Ministria theksoi se bizneset shqiptare duhet të përdorin dhe mundësitë e tjera që janë në dispozicion, siç është regjistrimi i bizneseve në EEN (Enterprise Europe Network- Rrjeti Europian për Sipërmarrjen), një platformë ku janë të regjistruar rreth 5000 sipërmarrje nga 64 shtete të botës. Në këtë rrjet, sipërmarrjet mund të gjejnë kompanitë që operojnë në të njëjtin sektor në vende të ndryshme dhe të bashkëpunojnë. Gjithashtu si mundësi tjetër, Ministria përmendi dhe programin COSME- programi i BE-së që ndihmon sipërmarrësit dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme në fazën fillestare të aktivitetit. Më tej, Ministria Ekonomi shpërndau 5 çmimet fituese të këtij konkursi. Fituesit ishin: Albana Mucaj, me idenë e saj për një qendër multifunksionale për fëmijë; Edlira Karaj, për një laborator krijues për fëmijë, Jona Veizi për një biznes fruta e perime të thata, Meliha Zyberi për artizanatin dhe Skënder Doci për një biznes turistik. Në këtë projekt konkurruan rreth 100 biznese start-up dhe u përzgjedhën 17 finalistë për të paraqitur idetë e tyre para një jurie të përberë nga AIDA, Yunus Social Business, Deloitte Albania dhe GIZ, të cilët në fund shpallën vetëm 5 ide fituese. <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-ekonomi-merr-pjese-ne-ceremonine-e-ndarjes-se-cmimeve-te-projektit-idea>

Standard i ri për turizmin aventuror në Shqipëri



Turizmi aventuror në Shqipëri duhet të ushtrohet sipas standardeve të përcaktuara qartë, në mënyrë që jo vetëm të plotësojë kërkesat e turistit dhe të kënaqë shijet e tij, por të garantojë në radhë të parë sigurinë e tij. Në këtë këndvështrim, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), institucion në Varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka publikuar në faqen e saj një standard të ri (SSH ISO 21101: 2014) mbi ushtrimin e “Turizmit aventuror - Sistemet e menaxhimit të sigurisë – Kërkesat”. Qëllimi i këtij standardi është përcaktimi i kërkesave minimale për një sistem të menaxhimit të sigurisë për ofruesit e aktivitetit të turizmit aventuror. Procesi i menaxhimit të rrezikut është një pjesë integrale e një sistemi të menaxhimit të sigurisë, i cili siguron kornizën për përmirësimin e vazhdueshëm dhe kontribuon në shpërndarjen e aktiviteteve të sigurta të turizmit të aventurës. Pasi të plotësojë gjithë kushtet e këtij standardi, subjekti duhet të certifikohet nga kompanitë certifikuese vendase ose të huaja. Plotësimi i një standardi të tillë për ofruesit e këtij turizmi aventuror, garanton cilësi dhe besueshmëri për turistin vendas dhe të huaj. MZHETTS është e vendosur të ndërmarrë masat e nevojshme, që Shqipëria të ofrojë turizëm aventuror të sigurt dhe të kënaqshëm, në mënyrë që turistët që e pëlqejnë këtë lloj turizmi të vijnë duke u rritur.

MZHETTS monitoron zbatimin e projektit të Art Kontakt për itinerarin e Trashëgimisë së Ali Pashë Tepelenës



Më 9 dhjetor, në mjediset e Universitetit Polis, Qendra Art Kontakt prezantoi rezultatet e një studimi për krijimin e itinerareve turistike e kulturorë në një territor të sunduar nga Ali Pashë Tepelena, i mbështetur financiarisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS). Të pranishëm ishin dhe përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të cilët monitorojnë zbatimin e këtij projekti dhe rezultatet e tij. Projekti i Korridorit Turistik të Ali Pashë Tepelenës ishte një prej 5 subjekteve fituese të fondit të turizmit të MZHETTS, të shpërndara në thirrjen e 1-rë gjatë këtij viti. Ky projekt ka qëllim të krijojë kushtet për krijimin e korridorit/itinerarit kulturor turistik të Ali Pashë Tepelenës, bazuar në rrjetin e kalave, urave dhe dhjetëra vendbanime objekte etj., të ndërtuara gjatë sundimit të Ali Pashës si dhe ta promovojë këtë produkt brenda dhe jashtë Shqipërisë. Projekti synon që të nxisë dhe pjesëmarrjen aktive të banorëve që jetojnë në këtë territor të shtrirë dhe operatorëve ekonomikë, në mënyrë që trashëgimia historike e Ali Pashë Tepelenës të mund të shndërrohet në faktor zhvillimi ekonomik turistik të zonës. Studimi i prezantuar, krahas identifikimit të trashëgimisë historike kulturore të Ali Pashë Tepelenës, ndërton tre itinerare kryesorë të tij shoqëruar me hartat përkatëse. MZHETTS do të vazhdojë të mbështesë të tjera projekte dhe produkte turistike që promovojnë vendin tonë, rrisin numrin e turistëve, por gjithashtu ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të zonave ku këto produkte turistike ndodhen apo aplikohen.

Ambasadori Izraelit, z.Boaz Rodkin viziton Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve



Ambasadori i Izraelit në Tiranë, z. Boaz Rodkin ka zhvilluar një vizitë në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, ku u njoh me shërbimet që AIDA ofron për investitorët që duan të vijnë të investojnë në Shqipëri. Qëllimi i këtij takimi ishte thellimi i bashkëpunimit në drejtim të promovimit të mundësive për investim në Shqipëri, të krijimit të një klime të favorshme për forcimin e bashkëpunimit dhe partneritetit mes bizneseve shqiptare dhe atyre izraelite, si dhe vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta me organizatat e biznesit. AIDA, në zbatim të misionit të saj konfirmoi dhe njëherë ndihmën për sipërmarrjet izraelite në Shqipëri megjithëse ende e pakët dhe asistencën për të gjithë ato që synojnë tregun shqiptar për të investuar në fushat strategjike si bujqësi, turizëm, energji dhe infrastrukture.

Qeveritë e Izraelit dhe Shqipërisë në këto vite të vendosjes se marrëdhëniet diplomatike kanë vazhduar bashkëpunimin, i cili ka arritur të përfundojë marrëveshje dypalëshe në fushat të tilla si; bashkëpunimi në fushën e bujqësisë, të tregtisë dhe të bashkëpunimit ekonomik, si dhe në fushën e mjekësisë veterinarë, shërbimeve ajrore; për bashkëpunim në fushën e kulturës, arsimit dhe shkencës, në fushën e mbrojtjes së bimëve etj. Një hap i madh është edhe krijimi i forumeve dypalëshe të biznesit, shkëmbimi i delegacioneve të biznesit nga dy vendet, takimet biznes me biznes, krijimin e Dhomës së Tregtisë Shqipëri- Izrael, etj. Qeveria Shqiptare është e interesuar në sjelljen e investimeve izraelite në Shqipëri. Ata janë të pranishëm në bujqësi, sektorin e energjisë, ndërtimit, në sistemin e kujdesit shëndetësor, transportit detar të anijeve, të gazit, kontrollit dhe monitorimit dixhital dhe telekomunikacionit.

National Geographic Travel rekomandon “Via Dinarica” si një ndër 5 udhëtimet më të mira gjatë vitit 2017



Prestigjiozja amerikane National Geographic Travel rekomandon “Via Dinarica” si një ndër 5 udhëtimet më të mira në natyrë që duhen vizituar gjatë vitit 2017. Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Milva Ekonomi, bëri të ditur përmes një statusi në rrjetin social ‘facebook’ se “bashkë me Österreichische Botschaft Tirana/Ambasada Austriake Tiranë, tur operator të ndryshëm dhe partnerë të tjerë kemi krijuar një grup bashkëpunimi, i cili po punon që ky shteg rajonal të promovohet siç duhet dhe jetë një vlerë e shtuar në produktin turistik që ofron vendi ynë”. Brezi i quajtur Dinaric, po tërheq përherë e më shumë turistët e lëvizjes. Ky brez përfshin disa shtete evropiane dhe ballkanike. Pak kohë më parë, prestigjiozja britanike “The Guardian” e konsideroi si një nga dhjetë destinacionet kryesore të aventurës në Europë. Bëhet fjalë për “Via Dinarica”, një shtegtim në tetë shtete ku përshkohen 2,000 km. Me anë të këtij udhëtimi, të pasionuarit pas turizmit aktiv e të aventurës do të kenë mundësi të udhëtojnë përmes Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë- Hercegovinës, Malit të Zi, Shqipërisë, Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Via Dinarica, ky shtegtim i gjatë, i ka filluar në vitin 2009-2010, por Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi u shtuan si destinacione shtegtimi në vitin 2013



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania
Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55
E-mail: zmp@ekonomia.gov.al
Web: www.ekonomia.gov.al

